

NEWSLETTER: SHKURT 2026

Nga Analiza në Vendimmarrje: ACER dhe AIS Promovojnë Ndikimin e CPL në Legjislacion

Ky publikim zhvillohet në kuadër të projektit “Parlamenti dhe përfaqësuesit politikë angazhohen me organizatat e shoqërisë civile për të nxitur llogaridhënien dhe transparencën” zbatuar nga **Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)** dhe **Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)**. Iniciativa mbështetet nga **Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD)** në kuadër të projektit “Korniza e Ballkanit Perëndimor: Investim në Qëndrueshmërinë Demokratike”, financuar nga FCDO përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë. Projekti synon të forcojë rolin e advokimit dhe monitorimit në lidhje me Kuvendin e Shqipërisë, si dhe të zhvillojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të kuptuar dhe përdorur Metodologjinë e Vlerësimit Parandalues për Korrupsion.

Vlerësimi Parandalues për Korrupsion (CPL) është një metodologji e miratuar dhe tashmë e përdorur nga **Kuvendi i Shqipërisë** për të analizuar projektligjet dhe për të identifikuar rreziqet potenciale të korrupsionit. Ajo siguron që ligjet të jenë transparente, të drejta dhe të zbatueshme pa hapësira për abuzim, duke forcuar integritetin publik dhe duke nxitur më shumë llogaridhënie e transparencë në procesin ligjvënës.

PERGATITJA E ANALIZAVE CPL

Vlerësimin Parandalues për Korrupsion të Projektligjit për Parqet Teknologjike dhe Shkencore

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 58/2022 ‘Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore’” u përzgjedh për vlerësim CPL për shkak të përfshirjes së konceptit të ri të sektorit “Data Center”, i cili aktualisht nuk ka një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator, duke rritur pasigurinë dhe rrezikun e abuzimit. Gjithashtu, ndryshimet e propozuara ngritën shqetësime për favorizim të mundshëm dhe rrezik evazioni fiskal, përmes zgjerimit të lehtësive dhe marrëveshjeve të negociuara me ente publike.

Gjetjet kryesore nga CPL:

- **Respektimi i standardeve të transparencës dhe konsultimit publik:** Relacioni shoqëruar është i paplotë dhe projektligji nuk i është nënshtruar konsultimit publik. Mungojnë të dhëna konkrete mbi zbatimin e ligjit ekzistues dhe ndikimin e tij ekonomik e fiskal.
- **Qëllimet e ligjit:** Ndërsa projektligji synon përmirësimin e kuadrit ligjor për inovacionin, ai zgjeron në mënyrë të nënkuptuar veprimtaritë virtuale dhe përfitimet fiskale. Kjo krijon mospërputhje midis objektivave të shpallura dhe efekteve reale të dispozitave.
- **Interesat publike dhe private:** Projektligji lejon marrëveshje të negociuara dhe shoqëri të përbashkëta mes përdoruesve dhe enteve publike pa mekanizma të qartë konkurrues. Kjo rrit rrezikun e favorizimit, klientelizmit dhe cenimit të interesit publik.
- **Përshtatshmëria** Argumentimi i ndërhyrjes legjislative është i përgjithshëm dhe nuk mbështetet në evidenca konkrete mbi nevojën për ndryshim. Nuk analizohet nëse problemet mund të zgjidhen me masa jolegjislative apo përmirësime të zbatimit.
- **Implikimet financiare:** Megjithëse deklarohet se nuk ka efekte financiare, projektligji zgjeron lehtësitë fiskale dhe subjektet përfituese. Kjo mund të sjellë pakësim të të ardhurave buxhetore pa një analizë të qartë të ndikimit financiar.

ADVOKIMI



Tryeza e diskutimit për vlerësimin e projektligjit mbi parqet teknologjike dhe shkencore u zhvillua më 11 Shkurt me **27 pjesëmarrës**, përfshirë:

- 2 deputetë
- 2 përfaqësues nga media
- 1 përfaqësues nga sektori i biznesit
- 5 organizata në fushën e aktivizmit dhe të të drejtave të njeriut
- 8 organizata që veprojnë në fushën e sundimit të ligjit
- 1 institucion i pavarur publik – Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale


Deputetët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kontribuan aktivisht, duke diskutuar gjetjet e opinionit dhe duke theksuar nevojën për reflektimin e mangësive të projektligjit, për të siguruar një proces ligjvënës më transparent dhe efektiv.

Opinionin i përgatitur u shpërnda te **140 deputetë** të Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar reflektim mbi rekomandimet e paraqitura dhe organizimin e një seance dëgjimore për diskutimin e tyre.

Diskutimi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Parlamentit dhe shoqërisë civile për të siguruar një legjislacion që vendos interesin publik mbi çdo interes privat.

Përfaqësues i Kuvendit të Shqipërisë

[Lexo më shumë](#)



RRITJA E KAPACITETEVE

Si pjesë e këtij projekti, në periudhën e mëparshme ACER dhe AIS kanë organizuar dy trajnime me qëllim forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) për zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit Parandalues për Korrupsion, të miratuar dhe zbatuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në kuadër të këtij procesi, prezantimi i CPL u realizua përmes një bashkë-

prezantimi, ku krahas ekspertëve të projektit kontribuoi edhe një përfaqësuese e organizatës **Together for Life** znj. Eriselda Ndreca, pjesëmarrëse në trajnimet e zhvilluara më herët. Gjatë prezantimit, ajo theksoi se qëllimet e deklaruara të projektligjit nuk përputhen plotësisht me efektet reale të dispozitave të propozuara, duke ngritur shqetësime për mundësi favorizimi të bizneseve apo aktorëve të caktuar.

Ndikimi i CPL në Legjislacionin e Miratuar

Në kuadër të ndjekjes së rekomandimeve të mëparshme, u analizua niveli i adoptimit të gjetjeve të CPL për ndryshimet në Ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” dhe për projektligjin “Për Policinë e Shtetit”. Analiza tregoi se, ndonëse një pjesë e rekomandimeve u reflektuan në ligjet e miratuara duke forcuar mekanizmat e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit institucional disa rekomandime të tjera, veçanërisht ato që lidhen me kufizimin e diskrecionit administrativ, konfliktin e interesit dhe garancitë e integritetit, nuk u përfshinë në tekstet përfundimtare të ligjeve.

MBULIMI MEDIATIK



Prezantimi i CPL dhe gjetjeve mbi ndryshimet në ligjin për parqet teknologjike dhe shkencore u publikuan në kanalet zyrtare të ACER dhe AIS, përfshirë rrjetet sociale dhe faqet zyrtare të internetit, duke siguruar informim të drejtpërdrejtë të publikut. Aktiviteti u pasqyrua dhe u shpërnda nga disa media kombëtare, duke kontribuar në zgjerimin e debatit publik mbi transparencën, rreziqet e mundshme për evazion fiskal dhe rëndësinë e forcimit të integritetit në procesin ligjvënës.

Media që e kanë pasqyruar aktivitetin:

- *BIRN Albania*
- *Gazeta Telegraf*
- *Gazeta Standard*
- *Albaniannews365*

[Lexo më shumë](#)

TË FUNDIT

Kërkime dhe analiza të politikave nga ACER dhe AIS për forcimin e integritetit dhe qeverisjes në Shqipëri.

ACER

ACER, themeluar në vitin 1992, është një nga organizatat më të hershme të pavarura në Shqipëri, e fokusuar në kërkime ekonomike, qeverisje dhe luftën kundër korrupsionit. ACER realizon studime, analiza politike dhe aktivitete advokuese për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe integritetin institucional, duke angazhuar qytetarët, bizneset dhe institucionet publike në një dialog të bazuar në evidenca.



AIS

AIS, i themeluar në vitin 2011, është një organizatë e shoqërisë civile e dedikuar promovimit të transparencës, qeverisjes së mirë dhe të dhënave të hapura në Shqipëri. AIS zhvillon platforma digjitale, kryen kërkime dhe monitoron prokurimet publike, zgjedhjet dhe shpenzimet qeveritare, me qëllim luftimin e korrupsionit dhe fuqizimin e qytetarëve me informacion të aksesueshëm dhe të bazuar në evidenca.



Mendimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të WFD ose të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar.

